

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.22 Regj. Themeltar, Datë 16.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Kryetari i Bashkisë Elbasan, Gledian Llatja.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.84, datë 08.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve “Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”, për pjesën që ka të bëjë me vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, duke vendosur sanksionin sipas nenit 171, pika 2, të Kodit Zgjedhor nga 1 000 (një mijë) deri në 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë.

Më datë **16.05.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Esmeralda Xhili (Anëtare).**

Me Urdhër datë 16.05.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **24.05.2023, ora 14:30**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në: **ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.**

Tiranë, më 16.05.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë